



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E KOPSHTIT ZOOLOGJIK
TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____, _____, 2026

Shtojca 13.

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor në rastin e Marrëveshjes Kuadër]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË
MARRËVESHJEN KUADËR, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË AFATET E
ANKIMIMIT**

Datë: 09.03.2026

Drejtuar: Operatorit Ekonomik **ARGENT DACI P.F me Nipt L01914003T** me adresë;
Tirane, Kamez KAMEZ, Rruga Abdi Bej Toptani, godina nr.21, poshte ktheses se Valiasit.

☐ _____ ose

Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) ☐

[Emrat, Nipt-et, % përkatëse dhe adresat e anëtarëve të BOE]

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat: _____

[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]

Tipi i Kontratës: **Mallra**

Lloji i Procedurës së prokurimit: **Procedurë e Hapur**

Numri i referencës së procedurës /Lotit: **REF- 75568-02-09-2026**

Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: **Blerje mish dhe organe për ushqimin e kafshëve**

Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): **15110000-2 – Mish**

Fondi limit: **10.831.500** (dhjetë milion e tetëqind e tridhjetë e një mijë e pesëqind) lek pa tvsh.
Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e nënshkrimit të Marrëveshjes Kuadër.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: **Datë 02.03.2026**

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike: **Buletini Nr.Prot 17 datë 2 Mars 2026.**

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim **X**

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik **ARGENT DACI PF me Nipt L01914003T** me ofertë ekonomike **10,805,000.00** (Dhjetë milion e teteqind e pese mije) lek pa tvsh.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO **X**

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2. Operatori ekonomik **“Mc Catering” shpk me Nipt K72218022J** me ofertë ekonomike **8.560.000.00** (Tetë milion e pesëqind e gjashtëdhjetë mijë) lek pa tvsh.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO **X**

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesi i mëposhtëm:

Operatori ekonomik **“Mc Catering” shpk me Nipt K72218022J** me ofertë ekonomike **8.560.000.00** (Tetë milion e pesëqind e gjashtëdhjetë mijë) lek pa tvsh.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO **X**

Nëse po, të jepen dhënat _____

Operatori ekonomik nuk plotëson pikën si më poshtë:

Kriteret e veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST;

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.4 Kandidati/Operatori ekonomik ofertues të paraqesë Licence leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit (QKB) me kategoritë e mëposhtme:

Kategoria: II.1 Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve.

Nënkategoria: II.1.A. “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve”,

Licenca duhet të jetë në emër të operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurë pasi duhet ti përkasë operatorit të interesuar të ofertojë për procedurën e prokurimit të shpallur nga Autoriteti Kontraktor.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë secili prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve duhet të ketë Licensën.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Per prokurimin publik” i ndryshuar në të cilin përcaktohet se:

” 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.”

Nga sa përcaktohet dhe më sipër kriteri kualifikues i sipërpërmendur është në përputhje dhe me parashikimet e nenit 40 pika 5/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet që në rastin e procedurave të prokurimit të mallrave mund të kërkojë që operatorët ekonomikë ofertues të jenë të pajisur me licensa profesionale për furnizimin e mallrave objekt prokurimi.

Në bazë të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik me **Nr.Vendimi 274/2024 me Nr.Prot 113/14 data 12.03.2024**, vendimi i cili lidhet për të njëjtën procedurë, kanë arsyetuar se Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë ofertuesit në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe nuk mund të kualifikojë operatorë ekonomikë që nuk provojnë disponimin. Licenca duhet të përcaktojë qartë veprimtarinë specifike për të cilën subjekti është licencuar. Në këtë kuptim, fakti që një operator disponon licencë të kategorisë II.1.A nuk mjafton nëse në të nuk është e

përcaktuar specifikisht veprimtaria për prodhim, përpunim dhe shpërndarje të mishit dhe produkteve me bazë mishi.

Për rrjedhojë, Operatori Ekonomik “MC CATERING” shpk në mungesë të kësaj veprimtarie specifike në licencë (Mish dhe nenprodukte te tij), operatori ekonomik nuk arrin të provojë përmbushjen e kriterit të kërkuar dhe nuk mund të kualifikohet në procedurën e prokurimit.

Për sa më sipër, konstatohet se licenca e paraqitur nga operatori ekonomik nuk përfshin veprimtarinë specifike për prodhim, përpunim apo tregtim të mishit dhe produkteve me bazë mishi, në përputhje me objektin e kontratës (CPV 15110000-2 – Mish).

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin ekonomik, **ARGENT DACI P.F me Nipt L01914003T** me adresë; Tirane, Kamez KAMEZ, Rruga Abdi Bej Toptani, godina nr.21, poshte ktheses se Valiasi, me ofertë ekonomike **10, 805,000.00 (Dhjetë milion e tetëqind e pesë mijë)** lek pa tvsh, se është identifikuar si ofertues i sukseshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” *(i ndryshuar)*.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

Ervis RAHMANI